



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data \_\_. \_\_. 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: "Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë, Zona Suk, Bashkia Roskovec"**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime gërrmuese-45112400-9; Punime inxhinerike dhe ndërtimi-45220000-5; Punime argjiture-45243510-0;**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 41 520 230 (dyzetë e një milion e pesëqindë e njëzetë mijë e dyqindë e tridhjetë) lekë pa tvsh.**

**Argumentimi i fondit limit:** Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit ka marr në dorëzim project-preventivin dhe dokumentacionin teknik përkatës të hartuar nga Shoqëria "Selas Ltd" sh.a i cili rezulton se është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, që përcakton "çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)", Shoqëria "Selas Ltd" sh.a për llogaritjen e cmime është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015, (ndryshuar me VKM-në nr.631, datë 26.10.2018, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit : "E hapur" Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit është sepse fondi limit është mbi kufirin e ulët monetar në sektorin klasik, bazar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" nenin 42 dhe 52 ;në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"nenin11, pika 1, gërma b) dhe neni

47,74,77 ,si dhe në VKM nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”;;”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte.Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

*c. Formulari i Ofertës ,sipas Shtojcës 1*

*d.Lista e çmimeve të artikujve sipas zërave të preventivi sipas shtojcës 2;*

*Shenim:Dokumentat e kërkuara më sipër në pikën c dhe d do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik,i ndryshuar”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojces 1 dhe 2 te DST).

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriteve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”;nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, *Pika 4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.*

*Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet e përkatësisht: 41 500 000 lekë pa tvsh.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

---

*Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike”.*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2021, 2022 dhe 2023, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore,

të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin 2023** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore .

Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

***Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "PërSistemin e TaksaveVendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d). Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen eaktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme :

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pese viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës e përkatësisht: 20 500 000 lekë pa tvsh.

### **Ose**

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet e përkatësisht: 83 000 000 lekë pa tvsh.

*\*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, **Pika 2.3.1/a** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore;
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ,i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a(1,2,3,4) dhe b(1,2,3,4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

- N.P-1 A Punime gërmimi në tokë.
- N.P - 9 B Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime
- N.P-4 A Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
- 

**Për punimet speciale të ndërtimit:**

- N.S-9 A Punime strukturore speciale.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 39, pika

6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategorite dhe nivelet e licencave te kerkuara jane bazuar ne Lidhjen 2,3 dhe 4 te VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

<b>KATEGORIA</b>	<b>Pershkrimi i kategorise sipas legjislatonit te fushes</b>	<b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>	<b>Niveli i klasifikimit i kërkuar per kategorie respektive</b>
N.P. 1-A Punime gërmimi në tokë	Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e	<p>Gërmim e transport dheu per skarifikim trupit te argjinatures ekzistuese ne zonat e dëmtuara.</p> <hr/> <p>Mbushje e ngjeshje me dhë ( me shtresa 30 cm ngjeshje me tokmak elektrik) per riparimin e argjinatures në zonat e çara ( ne forme rampash, shih detajin ) perfshi dhe rakordimet me argjinaturen</p> <hr/> <p>Rrafshim skarpate ne gërmim per trupin e rampave, pas mbushjes</p> <hr/> <p>Gërmim e transport dheu per skarifikim trupit te argjinatures ekz. ne zonat e çara</p> <hr/> <p>Mbushje e ngjeshje me dhë ( me shtresa 30 cm ngjeshje me tokmak elektrik) per riparimin e argjinatures në zonat e çara ( ne forme rampash, shih detajin ) perfshi dhe rakordimet me argjinaturen</p> <hr/> <p>Rrafshim skarpate ne gërmim per trupin e rampave, pas mbushjes</p> <hr/> <p>Gërmim e transport dheu per skarifikim trupit te rrugeve qe do te</p>	Niveli A

	terrenit që do të gërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.	trajtohen <hr/> Mbushje e ngjeshje me shtersa për trasetë e rrugëve <hr/> Germim dheu me krah për kanalet anesor <hr/> Germim dheu me makineri për kanalet anesor <hr/>	
NP-4 A - Rrugë autostrada, mbikalimi, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pikat të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punimet mureve mbajtëse,	Ndertim shtrese cakelli me mbeturina kave me makineri $t=10$ cm, <hr/> Shtrese stabilizanti $t= 5$ cm granil + 10 % argjil, përfshi edhe bankinën nga një anë me <hr/> Shtresë me rere bituminoze $t = 10$ cm	Nivel i A



	<p>hekurudh a, metro, hekurudh ë me kavo, tramvaji, pista aeroportu ale, sheshet e helikopte rëve, sheshet të realizuar a me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale , urat, si dhe kompleks e karakteri stikash teknike, në hekur, betonarm e të thjeshtë dhe të parander ur, parafabri kat ose të prodhuar në objekt. Konsider ohen ndërtime, mirëmbaj tje ose ristruktur</p>		
--	--	--	--

	<p>im i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompleti i çdo veprë lidhëse, plotësues e ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.</p>		
<p><u>NP-9 A</u> Punime mbrojtje lumore, sistemi me hidraulike dhe bonifikime.</p>	<p>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrjetë saktë ose në rrjet, sidore që të jenë realizuar, të</p>	<p>Germime me eskavator për punime devijimi të pjesëshme Germime me eskavator për punime devijimi të pjesëshme</p>	<p>Niveli A</p>

	<p>nevojshë m për sistemimi n e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale , si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletu ara me punimet lidhëse të nevojshm e. Përfshin në mënyrë të thjeshtua r kanale lundruese , grykëder dhjet e lumenjve , konsolidi min e struktura ve të anëve të lumenjve dhe përrenjve , argjinatur a të</p>		
--	---	--	--

	<p>Ilojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.</p>		
<p><u>NS-9 A</u> Punime strukturore speciale.</p>	<p>Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetimin ngarkesë të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuar</p>	<p>Ndërtim peneli mbrojtës TIP me <math>L = 33.5</math> ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure kave masiv, pozicioni nr 2 dhe pozicioni 7 (analize)</p> <hr/> <p>Idem, peneli mbrojtës TIP me <math>L=35.5</math>, në pozicionin 3 ( analize )</p> <hr/> <p>Ndërtim peneli mbrojtës TIP me <math>L = 37.5</math> ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure masiv, në pozicionin nr 8 - 8 (analize)</p> <p>Ndërtim peneli mbrojtës TIP me <math>L =32.5</math>; <math>h=3.5</math>m , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure (shih analizen)</p> <hr/> <p>Idem me <math>L =38.5</math> m (shih analizen)</p> <hr/> <p>Idem me <math>L = 34.5</math>m (shih analizen)</p>	<p>Niveli A</p>

	<p>a për t'u ndërtuar në terrene rezistonte dhe jo të deformue shme, por me parashiki me të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmi k të struktura ve ekzistues e.</p>		
--	--	--	--

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme (sipas Lidhjes 3)

- Kategoria NP-1 A (Punime gjurmimi në tokë)

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë gjurmimet për themelet e godinës së re, gjurmim për kanalizimet KUZ të shkollës, gjurmime dhe sistemime të ndryshme të shesheve për ndërtimin e terreneve sportive, operatori ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NP-4 A - Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristika teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndërjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të

veçantë, të linjës hekurudhore, operatori ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë per keto punime

Kategoria NP-9 A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, sido që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale, si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve, operatori ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë per keto punime

Kategoria NS-9 A Punime strukturore speciale. Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizim dhe konsolidimin e terreneve, operatori ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë per keto punime

**2.3.3. a.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- |                                 |           |
|---------------------------------|-----------|
| - Inxhinier Ndertimi            | - 1 (një) |
| - Inxhinier Hidroteknik         | - 1 (një) |
| - Inxhinier Ndertimi Gjeoteknik | - 1 (një) |

**Për secilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV
- Licence

Secili prej drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

**Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese inxhinieret e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

\* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe daten e certifikates, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**b.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi me profil menaxherial

**Për secilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV

**Inxhinieri i mesiperm të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit kur është pjes e stafit të shoqëris ndërsa kur është siguruar nga operatori ekonomik me anë të marrëdhënies kontraktore**

**për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi nuk kërkohet të figuroj në listëpagesat përkatëse.**

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" I ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi me profil menaxherial-Kërkesa është vendosur për arsye se ka punime shumë specifike me më të lartë dhe volume pune të mëdha prandaj kërkohet ky inxhinier për organizimin dhe menaxhimin e punimeve.

**c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:**

<b>EMERTIMI</b>	
Teknik të mesëm ndërtimi	(2 persona)
Teknik të mesëm topograf	(1 person)
Karpentier	(2 persona)
Hekurkthyes	(2 persona)
Murator	(4 persona)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, Operatorët Ekonomikë duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomes/certifikates së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjes për formimin profesional).

<b>Nr.</b>	<b>Emër Mbiemër i punonjësit</b>	<b>Profesioni</b>	<b>Nr i amzes/regjstrit dhe data e</b>	<b>Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës</b>	<b>Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)</b>
------------	----------------------------------	-------------------	--	---	---



			<b>leshimit</b>		
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
  - Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (certifikatë/deshmi), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.”
- \*(Per tekniket e mesem duhet te paraqitet diploma ose deftesa e perfundimit te shkolles se mesme profesionale).*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

*Argumentimi : Kërkesat e gërmes c) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Tekniku i mesëm i Ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivave të punimeve. Kerkesa e AK perTeknike Ndertimi vjen pasi objekti i prokurimit do te jete i shtrire ne disa fronte njekohesisht
- **Tekniku i mesëm topograf** është i nevojshëm për matjet e nevojshme zbatimin e projektit .
- **Karpenier** është kerkuar per te realizuar punimet e armaturave ne beton duke patur parasysh volumin e punimeve me hekur beton referuar preventivit dhe specifikimeve teknike.

- **Hekurkthyes** eshte kerkuar per te realizuar kthimet e hekurit, kornizat e hekurit ne armaturat e betonit ne punimet e betonit. Keta punonjes realizojne kthimet e hekurit, kornizat e hekurit ne armaturat e betonit ne punimet e betonit dhe shtrese betoni. Specialistet hekurkthyes presin, perkulin dhe vendosin rrjeta teli ne strukturat e betonit. Në bazë të zërave dhe sasive që përfshihen në preventivin e kontratës si dhe në ecurinë reale të punimeve të këtij lloji.
- **Murator** eshte të nevojshëm për kryerjen e punimeve të muraturës dhe mure sipas zërave të preventivit të punimeve.

**d.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Manovratore 3 (tre)
- Shofer 7 (shtatë)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

*\* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e kerkuar si me sipër, emer/mbiemer, numrin dhe daten e deshmise së aftësisë profesionale.*

*\*(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**e.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 41 punetore të thjeshtë ndërtimi, për te cilët te paraqitet kontratat e punës si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit kur jan pjes e stafit të shoqërisë ose kur janë siguruar nga operatori ekonomik me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi nuk kërkohet të figuroj në listëpagesat përkatëse.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor*

*Argumentimi:* Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë llogaritur nepermjet analizave teknike nga antaret e NJ.P me profil inxhinier ndertimi, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendimit Nr. 216 Datë 13.04.2023 “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËRINFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM”. Numri I punëtorëve është si rezultat I analizës teknike që kanë antarët e NJ.P me profil inxhinier ndertimi, bashklidhur rocesverbalit në dosje kopje e analizë së llogaritjes teknike për nr e punëtorëve, mjeteve, makinerive sp.te ndertimit etj.

**2.3.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **52(pesëdhjetë e dy) persona te pasqyruar në listëpagesën e muajit e fundit.** Për përmbushjen e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve per muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per muajin e fundit.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pik. duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

*Argumentimi:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.*

*Numri i stafit kryesor dhe mbeshtetes eshte llogaritur ne baze te volumeve dhe grafikut te punimeve.*

**2.3.5. Numri dhe lloji i makinerive,paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Statusi</b>	<b>Sasia</b>
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës deri në 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Cope 3
Kamioncine me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
<b>Eskavator me zinxhir krahegjate</b>	në pronësi ose me qira	Cope 2
Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Cope 1
Grejder	në pronësi ose me qira	Cope 1
Rul vibrues	në pronësi ose me qira	Cope 2
AutoBetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator thellesie	në pronësi ose me qira	Copë 3
Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vinc	në pronësi ose me qira	Cope 1
Asfaltoshtruese/Makineri Asfalti	në pronësi / qira ose kontratë furnizimi	Cope 1
Moto/saldatrice	në pronësi ose me qira	Cope 1
Tokmak elektrik	në pronësi ose me qira	Cope 2
Pomp uji	në pronësi ose me qira	Cope 2
Skrepe me goma	në pronësi ose me qira	Cope 1

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit te vlefshme), duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese.
- d) Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedurë të shpallura fitues.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.5. duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi :** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlloritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.*

*Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës*

dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

**2.3.6.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatën e mëposhtme:

- **Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente** mbi **“Sistemet e menaxhimit të cilësisë”** lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pik. duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të të Ligjit Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” indryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikata e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve. ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **4(katër)** muaj kalendarike.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V,

Seksioni III, Neni 39, pika 3. **Ky kriter vendoset me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë shpërndarja e fuqisë puntore dhe e mjeteve me anë të një grafiku punimesh.**

**2.3.8** Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi** :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Punimet objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, bazohen në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Specifikimet teknike të këtij objekti prokurimi janë përcaktuar nga projektuesi, sipas materialit bashkëlidhur ne SPE.

\*\*\*

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, **nr.68, datë.12.06.2024**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **"Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë,Zona Suk,Bashkia Roskovec"** me fond limit prej: **41 520**

**230(dyzetë e një milion e pesëqindë e njëzetë mijë e dyqindë e tridhjetë)lekë pa tvsh,, lloji i procedures: E hapur.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

\*\*\*

**Preventivi I hartuara nga Shoqëria“Selas Ltd” sh.a si mëposhtë për objektin”: "Mbrotjtje nga lumi Seman në krahun e majtë,Zona Suk,Bashkia Roskovec".**

**PREVENTIVI PERMBLEDHES**

**Objekti : “Mbrotjtje nga lumi Seman ne krahun e majte zona Suk Bashkia Roskovec”**

Nr.	NR Anal	ZERAT E PUNES	Njesia	Sasia
<b><u>A. Mbrotjtje ne zonen Suk - Hoxhenj</u></b>				
1	3-160 a	Germim e transport dheu per skarifikim trupit te argjinatures ekzistuese ne zonat e dëmtuara.	m3	162
2	3-47/1a	Mbushje e ngjeshje me dhë ( me shtresa 30 cm ngjeshje me tokmak elektrik) per riparimin e argjinatures në zonat e çara ( ne forme rampash, shih detajin ) perfshi dhe rakordimet me argjinaturen	m3	324.8
3	3-161/1	Rrafshim skarpate ne germim per trupin e rampave, pas mbushjes	m2	522
4	An 1	Ndertim peneli mbrotjtes TIP me L = 33.5 ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure kave masiv, pozicioni nr 2 dhe pozicioni 7 (analize)	cope	2
5	An 2	Idem, peneli mbrotjtes TIP me L=35.5, ne pozicionin 3 ( analize )	cope	1
6	An 3	Ndertim peneli mbrotjtes TIP me L = 37.5 ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure masiv, në pozicionin nr 8 - 8 (analize)	cope	1
7	3-102/b	Germime me eskavator per punime devijimi te pjeseshme	m3	806.6
<b>Shuma A</b>				
<b><u>B. Mbrotjtje ne zonen Suk - Agaçaj</u></b>				
Nr.	Nr			
	Anal	ZERAT E PUNES	Njesia	Sasia



1	3-160 a	Germim e transport dheu per skarifikim trupit te argjinatures ekz.ne zonat e çara	m3	89
2	3-47/1a	Mbushje e ngjeshje me dhë ( me shtresa 30 cm ngjeshje me tokmak elektrik) per riparimin e argjinatures në zonat e çara ( ne forme rampash, shih detajin ) perfshi dhe rakordimet me argjinaturen	m3	123.8
3	3-161/1	Rrafshim skarpate ne germim per trupin e rampave, pas mbushjes	m2	236
4	An 4	Ndertim peneli mbrojtës TIP me L =32.5; h=3.5m , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure (shih analizen)	cope	1
5	An 5	Idem me L =38.5 m (shih analizen)	cope	1
6	An 6	Idem me L = 34.5m (shih analizen)	cope	1
7	3-102/b	Germime me eskavator per punime devijimi te pjeseshme	m3	723.02
		<b>Shuma B</b>		
		<b><u>C Punime per permiresimin e pjeseshem te rrugëve në të dyja zonat e ndertimit</u></b>		
1	3-160 a	Germim e transport dheu per skarifikim trupit te rrugëve qe do te trajtohen	m3	482.0
2	3-47/1a	Mbushje e ngjeshje me shtresa per trasetë e rrugëve	m3	45.2
3	3-45/1	Germim dheu me krah per kanalet anesor	m3	24.4
		Germim dheu me makineri per kanalet anesor	m3	206.6
4	3-209	Ndertim shtrese cakelli me mbeturina kave me makineri t=10 cm,	m2	4920.0
5	3-212/b	Shtrese stabilizanti t= 5 cm granil + 10 % argjil, perfshi edhe bankinen nga nje ane me b= =0.5m	m2	4920.0
6	An	Shtresë me rere bituminoze t = 10 cm	m2	4305.0
		<b>SHUMA C</b>		
		<b>SHUMA A + B +C</b>		
		<b>Fondi Rezerve 1.5%</b>		
		<b>Shuma</b>		
		<b>TVSH 20 %</b>		
		<b>Shuma Totale</b>		

Dokumentacioni pasi u firmos nga të 5(pesë) anëtarët e Njesisë së Prokurimit , pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

**NJËSIA E PROKURIMIT:**

